

VENDIM
Nr. 15, datë 7.5.2018

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 7.12.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 64/7 akti, që u përket:

KËRKUES: Spartak Gjikhima, Elion Shkurtaj, shoqëria “Food Catering” (Helios Catering) sh.p.k.

SUBJEKT I INTERESUAR: Kostandin Shkurti

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 2030, datë 16.3.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 679, datë 30.3.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2017-534, datë 27.4.2017, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/“P”, 134/1/“I” dhe 142/1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 71, 71/“a”, 71/“b”, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësit Spartak Gjikhima, Elion Shkurtaj dhe subjekti i interesuar Kostandin Shkurti janë ortakë të vetëm të shoqërisë “Helios Catering” sh.p.k. Sipas statutit të shoqërisë rezulton se të tre ortakët e shoqërisë janë edhe administratorë të saj. Me vendimin e datës 7.8.2013, asambleja e ortakëve të shoqërisë ka marrë vendimin për shkarkimin nga detyra të administratorit Konstandin Shkurtit. Ky i fundit, duke mos qenë dakord me këtë vendim, i është drejtuar gjykatës për zgjidhjen e konfliktit, duke kërkuar nga kërkuësit Spartak Gjikhima dhe Elion Shkurtaj (pala e paditur në procesin gjyqësor) që në mënyrë solidare t’i likuidojnë kuotën si pasojë e largimit nga shoqëria pa shkaqe të arsyeshme, t’i paguajnë fitimin e përfituar për vitet 2011–2013, si dhe t’i paguajnë sponsorizimin e bërë për llogari të shoqërisë. Po ashtu, ai ka kërkuar në gjykatë edhe deklarinimin të pavlefshëm të vendimit të asamblesë së ortakëve, si dhe detyrimin e të paditurve të paguajnë dëmin e pësuar etj.

2. Me vendimin nr. 2030, datë 16. 3.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: “*Pranimin e pjesës së kërkesëpadisë. Detyrimi i të paditurve që në mënyrë solidare t’i paguajnë paditësit vlerën e kuotave të tija në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “Helios Catering” sh.p.k. në vlerën 9.108.000 lekë. Detyrimi i të paditurve që në mënyrë solidare t’i paguajnë paditësit pjesën e fitimit të pashpërndarë të shoqërisë “Helios Catering” sh.p.k. Detyrimi i të paditurve që në mënyrë solidare t’i paguajnë paditësit për vlerat e marra hua nga shoqëria “Helios Catering” sh.p.k. në masën 9.174.725 lekë. Shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të ortakëve të shoqërisë “Helios Catering” sh.p.k. të marrë në*

mbledhjen e datës 7.10.2013 dhe detyrimi i të paditurve të paguajnë për dëmin e pësuar si rezultat i këtij vendimi në shumën prej 2.752.000 lekë. Detyrimi i të paditurve t'i paguajnë dëmin që konsiston në formën e fitimit të munguar nga ekzekutimi i kontratave të lidhura me të tretët ... Shuarjen për paditësin Kostandin Shkurti të të gjitha të drejtave, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqërinë "Helios Catering" sh.p.k. Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të saj."

3. Me vendimin nr. 679, datë 30.3.2016, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur të lërë në fuqi vendimin nr. 2030, datë 16.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kërkesit Spartak Gjikdhima dhe Elion Shkurtaaj.

4. Me vendimin nr. 00-2017-534, datë 27.4.2017, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

II

5. **Kërkesit Spartak Gjikdhima, Elion Shkurtaaj dhe shoqëria "Food Catering" sh.p.k** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), sipas objektit të kërkesës, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe:

5.1 Është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj, pasi në shkallë të parë çështja është gjykuar nga një gjyqtar i vetëm, ndërkohë që sipas vlerës së padisë duhet të gjykohej nga një trupë prej tre gjyqtarësh.

5.2 Është cenuar e drejta për t'u dëgjuar në gjykatë. Mosnjoftimi për procesin gjyqësor u ka cenuar kërkesve të drejtën e mbrojtjes në drejtim të parimit të barazisë së armëve dhe atij të kontradiktoritetit. Padijenja për zhvillimin e proceseve gjyqësore ka qenë rrjedhojë e mosnjoftimit të kërkesve, e vërtetuar kjo edhe nga vendimet gjyqësore, si dhe nga procesverbali i gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5.3 Vendimi i Gjykatës së Apelit karakterizohet nga mungesa e arsytimit dhe shkelja e parimit të barazisë së armëve dhe aksesit në gjykatë. Gjykata e Apelit jo vetëm që nuk ka marrë në konsideratë provat dhe ligjin, por dhe vetë ankimin, duke mos u dhënë përgjigje çështjeve të ngritura në të.

5.4 Është cenuar standardi i arsytimit të vendimit, si dhe e drejta për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar, pasi Gjykata e Lartë dhe pse shkaqet ligjore të ngritura në rekurs lidheshin me shkelje të rënda procedurale, ka vendosur mospranimin e tij në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve.

6. **Subjekti i interesuar Konstandin Shkurti**, në prapësimet me shkrim ka argumentuar sa vijon:

6.1 Pretendimi për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj nuk qëndron. Në kohën e ngritjes së kërkesëpadisë është kërkuar nga ana e palës së paditur një vlerë e përafërt që korrespondon me vlerën e kuotave të paditësit në shoqëri. Gjatë gjykimit, me kërkesë të paditësit, është caktuar një ekspert kontabël dhe në bazë të konkluzioneve të aktit të ekspertimit është bërë ndryshimi i objektit të kërkesëpadisë me vlerë të përcaktuar saktë. Nga ana e palës së paditur nuk është kërkuar në seancë gjyqësore që gjykimi të zhvillohej me tre gjyqtarë. Për më tepër, neni 35 i KPC-së nuk është dispozitë urdhëruese, por u jep të drejtë palëve ta kërkojnë një gjë të tillë.

6.2 I pabazuar është edhe pretendimi i kërkesve se nuk kanë pasur dijeni për procesin gjyqësor. Nga procesverbalet gjyqësore rezulton se të paditurit kanë pasur dijeni për gjykimin dhe se ata vetë, me kërkesa të vazhdueshme, janë përpjekur të zvarrisin gjykimin. Po ashtu, çdo provë e administruar në gjykim i është nënshtruar debatit gjyqësor në Gjykatën e Apelit dhe palës së paditur i është dhënë mundësia të debatojë mbi to në respektim të parimit të kontradiktoritetit në gjykim.

6.3 Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të arsytimit të vendimit të Gjykatës së Apelit, rezulton se ai është i mbështetur vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor, është logjik në formë dhe në përmbajtje dhe nuk ka asnjë kundërthënie. Pretendimet e palëve, provat dhe faktet janë interpretuar drejt dhe në harmoni me ligjin nga gjykatat e të tria shkallëve të gjykimit.

III Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesave

7. Kërkuesit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/“P” dhe 134/1/“I” të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/“a” i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

8. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, sipas nenit 131/1/“P” të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Gjykata ka theksuar se juridiksioni kushtetues për shkeljen e së drejtës themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor, çka nënkupton se kërkuesi duhet t’i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës të pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 28, datë 30.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ i t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instance, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr. 31, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Kërkuesit kanë pretenduar cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, pasi në gjykatën e shkallës së parë çështja është gjykuar nga një gjyqtar i vetëm, ndërkohë që sipas vlerës së padisë duhet të gjykohej nga një trupë prej tre gjyqtarësh. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, të administruar për qëllime të këtij gjykimi, vëren se ky pretendim i kërkuesve nuk është ngritur më parë në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë. Për sa kohë që ky pretendim nuk i është nënshtruar vlerësimit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe nuk është mbajtur prej tyre një qëndrim përfundimtar në lidhje me të, ai nuk mund të merret në shqyrtim nga kjo Gjykatë, pasi kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet ligjore në dispozicion.

10. Për sa u takon pretendimeve të tjera, Gjykata vlerëson se ato janë të tilla që *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimi të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

11. Sipas kërkuesve, ata nuk janë njoftuar për zhvillimin e procesit gjyqësor, për rrjedhojë është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit. Padijenja për zhvillimin e seancave gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë vërtetohet edhe nga vendimet gjyqësore, si dhe nga procesverbali i gjykimit në atë gjykatë.

12. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t’u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t’u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 30, datë 30.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. E drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar prej saj, vëren se në datën 23.2.2015, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë me të dyja palët prezent ka shtyrë seancën për në datën 5.3.2015. Në datën 5.3.2015 është verifikuar prezenca e palëve dhe av. S.H. i palës së paditur "Helios Catering" nuk është paraqitur, megjithëse ka pasur dijeni. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, në bazë të nenit 179 të KPC-së, ka vendosur ta zhvillojë gjykimin në mungesë të palës së paditur në kushtet kur është provuar se ka dijeni dhe pa shkaqe të arsyeshme nuk është paraqitur.

15. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi për padijeni për zhvillimin e seancave gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk vërtetohet nga vendimet gjyqësore, si dhe nga procesverbali i gjyimit në atë gjykatë, e për këtë arsye ky pretendim është i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

16. Sipas kërkesve, vendimi i Gjykatës së Apelit nuk është i arsyetuar, pasi jo vetëm që nuk ka marrë në konsideratë provat dhe ligjin, por as ankimin, duke mos u dhënë përgjigje çështjeve të ngritura në të.

17. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjyimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Gjykata ka theksuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimin nr. 12, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 10, datë 13.2.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar.

19. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkesve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit nga Gjykata e Apelit është haptazi i pabazuar. Duke vlerësuar përmbajtjen e këtij vendimi në këndvështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, Gjykata

vlërëson se vendimi i kundërshtuar nuk rezulton të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e përmendura më sipër.

Ç. Për pretendimin për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë

20. Sipas kërkesësve edhe pse shkaqet ligjore të ngritura në rekurs lidheshin me shkelje të rënda procedurale, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve.

21. Sipas nenit 133/2 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese merr vendim përfundimtar me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj. Kjo dispozitë kushtetuese është reflektuar edhe në përmbajtjen e nenit 72/2 të ligjit organik të Gjykatës, sipas të cilit vendimet e saj merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të saj dhe abstenimi nuk lejohet. Në lidhje me thelbin e këtij pretendimi të paraqitur nga kërkesit, Gjykata, gjatë votimit, nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj të kërkuar nga dispozitat e mësipërme. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 73/4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në kushtet kur nuk është formuar shumica e kërkuar prej 5 votash, kërkesa konsiderohet e rrëzuar.¹

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/“f” dhe 134/1/“i” të Kushtetutës, si dhe të neneve 71, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari

¹ Votuan pro pranimi të kërkesës gjyqtarët: Bashkim Dedja, Besnik Imeraj. Votuan për rrëzimin e kërkesës: Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, dhe Fatos Lulo.